



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 28.

Prishtinë, më 24.01.2012 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri. dhe Etem Arifi

Munguan: Elmi Reçica dhe Glauk Konjufca.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: Elita Vokshi e Florina Shala -OSBE, Florije Mehmeti - KDI, Dejan Čosic – ICO, Viktor Popovic, Shpend Emini - PER-K (Projekti për marrëdhënie Etnike të Kosovës), Veton Berisha – KKK (Këshilli Konsulltativ për Komunitete), Alban Bokshi– KPJ (Klubi për politikë të jashtme), Blerina Aliu – TV Koha Ditore dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverballi nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-88 për Arkivat, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.01.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik të Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-46 për Transmetimin Publik të Kosovës, të propozuara nga Komisioni funksional. Kërkoj nga anëtarët të deklarojnë nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohet Komisionit Funksional

Petar Miletic- në fjalinë e tij tha se ka marr pjesë gjatë hartimit të projektligjit në Durës, ku kanë qenë prezentë edhe përfaqësuesit e Qeverisë, mediat dhe shtoi se është punuar me përpikëri të plotë që të kemi një ligj gjithëpërfshirës.

Në fillim nuk është pajtuar me disa çështje të cilat rregullohen me këtë projektligj, andaj elaburoi çështjet vijuese.

Neni i projektligjit i cili flet për formimin e kanalit televiziv në gjuhën serbe është i përfillur nga plani i Ahtisarit dhe është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra bëhet fjalë për kanalin televiziv i cili duhet të formohet si kanal i licencuar i pavarur në gjuhën serbe në territorin e Kosovës. Ndërsa shtoi se deri sot ky plan nuk është realizuar nga Radiotelevizioni publik i Kosovës.

Shtjelloi çështjen lidhur me pronësinë e ish televizorit të Prishtinës e cila iu është ndarë RTK-së. Këtë çështje e ka diskutuar me përfaqësuesit e Bashkësisë ndërkombëtare dhe se ka marr përkrahje e plotë të tyre. Ai dha sqarim se me një nen nuk mund të rregullohet pronësia e një organi kaq të rëndësishëm medial, dhe se në anën tjetër duhet të mbrohen të drejtat e punëtorëve të ish televizionit të Prishtinës.

Si çështje tjetër me rëndësi është se projektligji nuk parasheh autonomin e kanalit televiziv të pavarur në gjuhën serbe por vetëm formimin e tij, e cila nuk plotëson interesat e komunitetit ton. Andaj kërkesa jonë është që të jemi pjesë integruese e emitueshmërisë së programeve të skemave programore të RTK-së dhe se të ndahet buxheti i veçantë.

Ai ka pasur takim me përfaqësuesit e ICO-së, të komisionit Evropian ku ka marr rekomandimet e tyre lidhur me pyetjet e formimit të bordit, fondit buxhetor dhe selinë e pavarur pas së cilës të njëjtat janë inkorporuar në amendamentet e komisionit funksional.

Në bazë të argumenteve të cekura ka kërkuar nga kryesia që Projektligj për Transmetimin Publik të Kosovës të shtyhet për një afat të caktuar, deri sa Projektligji në harmonizohet me standardet Evropiane.

Njëherit falënderoi komisionin funksional, për hartimin e amendamenteve të këtij projektligji.

Ai shprehu qëndrimin e tij se përkrah të gjitha amendamentet e komisionit funksional përveç amendamentit 15, dhe propozoi që amendamentet e grupit parlamentar SLS, të miratohet në emër të komisionit, me tekstin si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 37, paragrafi 1, ndryshon dhe thuhet:

Drejtorin e Televizionit, kanali në gjuhën shqipe, drejtorin e Radios dhe udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta e zgjedh Bordi i RTK-së, në bazë të konkursit publik, sipas propozimit paraprak të Drejtorit të përgjithshëm të RTK-së. Bordi i RTK-së zgjedh edhe drejtorin e kanalit në gjuhën serbe, në bazë të konkursit publik, sipas propozimit paraprak të Grupit punues për zgjedhjen e drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe.

Paragrafi 1 i Nenit 37, shtohen dy nënparagrafë:

- 1.1. Bordi i RTK-së formon Grupin punues për zgjedhjen e drejtorit të kanalit në gjuhën serbe, i cili bën selektimin e kandidatëve dhe ia propozon Bordit kandidatin për drejtor të kanalit në gjuhën serbe.
- 1.2. Grupi punues për zgjedhjen e drejtorit të kanalit në gjuhën serbe përbëhet nga tre deputetë të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e komunitetit serb, si dhe nga një përfaqësues nga Ministria për Kthim, Zyra e Kryeministrit për Komunitete, Këshilli Konsultativ për Komunitete pranë Kabinetit të Presidentit, sektori civil dhe Radio-Televizioni i Kosovës.

Kryesuesi –theksoi se jemi të gjithë në dijeni se Projektligji për Transmetimin Publik të Kosovës është i përfshirë nga plani i presidentit Ahtisari dhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Projektligji është i një rëndësie të veçantë kur bëhet fjalë për shërbimin medial i cili destinohet për shfrytëzim publikut në territorin e Kosovës.

Ai theksoi se me amendamentin e propozuar nga grupi parlamentar SLS, do të rregullohet hapja e kanalit televiziv për komunitetin serb dhe për komunitetet tjera si dhe aprovimi i zgjedhjes së drejtorit nga Bordi i RTK-së, në bazë të konkursit publik.

Lirije Kajtazi- ajo ceku se gjatë hartimit të amendamenteve në Projektligj për Transmetimin Publik, komisioni funksional është përmbajtur rregullave të bazuara në planin e Ahtisarit dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Si anëtarë e komisionit për arsim, kulturë rini,...qeverisje Lokale dhe Media, njoftoi komisionin se gjatë hartimit të amendamenteve janë shqyrtuar të gjitha rekomandimet. Dha sqarim se me këtë projektligj do të ofrohet transmetimi i programeve si për komunitetin shqiptar ashtu edhe për komunitetin serb dhe komunitetet tjera.

Ajo propozoi që të mos ndryshohet rekomandimi me amendamentet i komisionit funksional.

Petar Miletic – pajtohet me parafolësen se edhe komunitetet tjera duhet ti kenë mediat e tyre.

Me amendamentet tani të propozuara nga komisioni funksional, shihet se me këtë Projektligj planifikohet ndarja e përqindjes prej 15 % nga dy kanalet televizive në gjuhën shqipe dhe serbe, të skemës së tyre programore për transmetim dhe informim në gjuhën e komuniteteve tjera të Kosovës. Sa i përket kanalit të RTK-së, deri sot nuk i ka plotësuar kërkesat tona me përqindje sa i parasheh projektligji.

Lumnije Morina- ishte e mendimit se komisioni duhet të jetë transparent kur është fjala për respektimin e procedurave Parlamentare të Kuvendit.

Dha sqarim se grupi parlamentar SLS, ka qenë i obliguar të paraqet propozim amendamentet e tyre në komisionin funksional, për shqyrtim. Ajo shtoi se është tejkaluar afati kohor për procedim të mëtejshëm të amendamenteve, në këtë komision.

Petar Miletic – lidhur me amendamentet e grupit Parlamentar SLS, ka ritheksuar se është takuar me kryetarin e komisionit z. Idriz Vehapi. Në atë komision kemi anëtarin e komunitetit tonë, i cili ka propozuar amendamentet e grupit parlamentar SLS, dhe konstatoi se nuk janë miratuar nga komisioni funksional. andaj propozoi që të njëjtat të miratohen në këtë komision.

Albert Kinolli – vlerësoi kontributin e dhënë nga komisionit funksional që të kemi një ligj gjithëpërfshirës për të gjitha komunitetet.

Në diskutimin e tij tha, se programi i RTK edhe pse subvencionohet nga parapaguesit, deri para disa muajve ka transmetuar program informativ vetëm gjysmë ore në javë, për komunitetin romë. Pjesa dërmuese e komunitetit romë jetojnë nga skema sociale por ata janë parapagues të rregullt të programit televiziv. Shprehu vullnetin e tij se me këtë ligj RTK-ja do të ofroj shërbim linear edhe për komunitetin romë.

Në bazë të amendamenteve përfundimtare të komisionit funksional, shihen faktet se RTK-ja përbëhet nga dy kanale televizive, në gjuhën shqipe dhe atë në gjuhën serbe.

Ai përkrah amendamentet e grupit Parlamentar SLS, me arsyetim se do të kemi ligje funksionale për të gjithë qytetarët e jo vetëm për një komunitet të caktuar.

Eetem Arifi- Sa i përket propozimit të komisionit funksional dhe propozimit të grupit Parlamentar të SLS, ku këto të dytat nuk janë proceduar në formë të rregullt, ai propozoi që kryetari të caktoj pauzë prej 15 min, dhe më pas komisioni të dal me qëndrim konkret.

Kryesuesi konstatoi se pas rezultateve të votimi me 9 (nëntë) për, dhe 1 (një) abstenim, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim nxori këtë:

Përfundim

I. Miratohen amendamentet e komisionit funksional në tërësi përveç amendamentit të 15.

II. Miratohet propozim amendamenti i grupit parlamentar SLS, në paragrafin 1 të nenin 37, dhe paragrafin 1 të nenin 37 i cili ndahet në nënparagrafin 1.3 dhe 1.4

Nënparagrafët e tjerë të Paragrafit 1 të Nenit 37 të këtij projektligji mbasin të pandryshuar dhe rirregullohen sipas radhës së numrave rendor.

III. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin me amendamentin e propozuar.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-88 për Arkivat, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryetari- i paraqiti për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-88 për Arkivat të Komisionit funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ato përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-88 për Arkivat dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapsinor, me amendamente.

Kryesuesi- paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, të propozuara nga Komisioni funksional.

Ai e njoftoi komisionin se lidhur me këtë projektligj janë të paraqitura tri kategori propozimesh: amendamentet e komisionit funksional, të Qeverisë dhe të deputeti Hydajet Hyseni.

Ai propozoi që komisioni të deklarohet në votim për njërin nga propozimet apo të votohet për cilin propozim veçmas.

Petar Miletic- Me theks të veçantë tha se gjatë leximit të parë të Projektligjit për fshatin Hoça e Madhe ka pas vërejtje të shumta në Seancë Plenare, por nuk ka dashtë të nxit polemik më të madhe. Me këtë projektligj rregullohet prona e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme dhe të kualifikuar si zonë e veçantë të mbrojtur. Theksoi se ky projektligj është pjesë e programit të Atisarit dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Njëherit respekton punë e komisionit funksional dhe propozimin e z, Hydajet Hyseni, por komisioni votoi kundër këtyre amendamenteve, sepse të njëjtat prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Sa i përket amendamenteve të propozuara nga Qeveria, tha se janë të hartuara mirë dhe shtoi se neni 4, është i bazuar nga plani i Atisarit.

Ai deklarohet për miratim të propozim amendamenteve të Qeverisë.

Kryesuesi propozoi të votohen propozimet e komisionit funksional dhe në bazë të votimit me 2 (dy) për dhe 8 (tetë) kundër, komisioni për Komunitete dhe Kthim konstatoi se me shumicë të votave të njëjtat nuk u përkraken.

Kryesuesi paraqiti në votim amendamentet e deputetit Hydajet Hyseni , dhe në bazë të votimit me 4 (katër) vota të përmbajtura, 5 (pesë) kundër dhe 1 (një) abstenim, komisioni për Komuniteteve dhe Kthim konstatoi se të njëjtat nuk u përkraken.

Kryesuesi propozoi të votohen amendamentet e Qeverisë dhe në bazë të rezultateve të votimit me 8(tetë) për, 1(një) kundër dhe 1(një) abstenim, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

- I.** Projektligji nr. 04/L-62 për fshatin Hoça e Madhe, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve
- II.** A) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara të Komisionit funksional dhe nuk i përkraku këto amendamente 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10 dhe amendamentin 12, ndërsa e përkraku amendamentin 11.
B) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe i përkraku që të gjitha në tërësi.
C) Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara nga deputeti Hydajet Hyseni, të cilat nuk i përkraku.
- III** Në bazë të asaj që u tha më lartë, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim i rekomandon Kuvendit që ta miratojë projektligjin së bashku me amendamentet e përkratura.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic